


# Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

## Shtator 2017

**Tiranë, më 23 Tetor 2017:** Ndryshimi vjetor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit në muajin Shtator 2017 është 2,7 %. Rritja më e madhe e çmimeve prej 6,7 %, vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike”, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 2,0 %, “Shërbimi arsimit” me 1,5 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,0 %, etj. Ndërsa çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Mobilje shtëpie dhe mirëmbajtje” u ulën përkatësisht me nga 1,7 %.


Në muajin Shtator 2017, ndryshimi mujor i matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është 0,5 %. Ky ndryshim është ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve prej 0,8 % e grupit “Ushqime dhe pije jo alkoolike” krahasuar me muajin paraardhës.

**Fig. 1 Krahasimi i ecurisë së IHÇK dhe IÇK-së**



Për publikim 23/10/2017


**Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor**



**Tab. 1 Ndryshimet në përqindje të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit**

Kodi	Grupet	Peshat	09-17/Vitë-2016	09-17/12-16	09-17/09-16	09-17/08-17
<b>Gjithsej</b>		<b>1.000,0</b>	<b>2,8</b>	<b>1,8</b>	<b>2,7</b>	<b>0,5</b>
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	380,2	6,5	5,1	6,7	0,8
02	Pije alkoolike dhe duhan	46,6	1,0	0,6	1,0	0,0
03	Veshje dhe këpucë	44,8	-0,9	-2,7	-1,7	2,2
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	75,6	1,6	0,9	2,0	0,3
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	69,5	-1,6	-1,6	-1,7	-0,1
06	Shëndeti	75,8	-0,1	-0,2	-0,2	-0,3
07	Transporti	71,9	1,2	0,2	-0,1	0,4
08	Komunikimi	20,7	0,2	-0,2	-0,1	0,0
09	Argëtim dhe kulturë	20,8	1,4	-0,4	0,2	0,0
10	Shërbimi arsimor	41,6	1,2	0,7	1,5	0,7
11	Hotele, kafene dhe restorante	99,2	0,0	-0,1	-0,1	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	53,3	2,3	0,2	0,2	0,0

Fig. 3 Ndryshimi vjetor i IHÇK sipas Shteteve, Shtator 2017



## Krahasimi midis IÇK-së dhe IHÇK-së

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) janë të dizenuar për të matur ndryshimin e nivelit mesatar të çmimeve të paguar për konsumin e mallrave dhe shërbimeve nga të gjithë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri. IÇK dhe IHÇK përdoren si matës të inflacionit të konsumit.

### - Ngjashmëritë midis IÇK dhe IHÇK

- *Qëllimi*

IÇK dhe IHÇK matin ndryshimin në nivelin mesatar të çmimeve të një shporte fikse mallrash dhe shërbimesh të konsumit.

- *Sistemi i klasifikimit*

IÇK dhe IHÇK përdorin të njëjtin klasifikim të mallrave dhe shërbimeve - Klasifikimi Evropian i Konsumit Individual sipas Qëllimit (ECOICOP)

- *Shpenzimet dhe burimi i të dhënave të shpenzimeve*

Përfshihen vetëm shpenzimet brenda territorit të Shqipërisë. Burimi kryesor i të dhënave për shpenzimet ("peshat") është Anketa e Buxhetit të Familjeve (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare "Shpenzimet Monetare të Konsumit Final të Familjeve (HFMCE).

- *Të dhënat e çmimeve*

IÇK dhe IHÇK llogariten bazuar në çmimet e mbledhura në të njëjtat njësi tregtare, përdorin të njëjtin klasifikim të produkteve dhe ndajnë të njëjtën metodologji të hartimit të indeksit.

- *Periodha referuese (bazë) t*

IÇK dhe IHÇK llogariten duke pasur si periudha muajin Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100)

- *Metodologjia*

IÇK dhe IHÇK ndjekin të njëjtën metodologji në hartimin dhe grumbullimin e komponentëve të indekseve të çmimeve që ndjek Rregullorja e Komisionit Evropian (KE), Nr 2494/95, mbi IHÇK, që janë zhvilluar nga Eurostat (Zyra e Statistikave e BE-së), në bashkëpunim me Institutet Statistike Kombëtare të vendeve anëtare të BE-së.

### - Dallimet ndërmjet IÇK dhe IHÇK

- *Matës të inflacionit të Çmimeve të Konsumit*

- IÇK është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri

- IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve.

- *Mbulimi i produkteve*

- IÇK përmban 332 produkte

- IHÇK përmban 331 produkte (qiraja e imputuar nuk është element i shportës)
- *Mbulimi dhe burimi i të dhënave për shpenzimet (peshat)*
- Në IÇK mbulohen vetëm shpenzimet e familjeve private shqiptare të kryera brenda dhe jashtë territorit të vendit.
- IHÇK mbulon të gjitha shpenzimet e bëra brenda territorit të vendit nga familjet shqiptare, përfshirë familjet private, kolektive dhe shpenzimet e turistëve në Shqipëri.
- *Peshat*
- Në IÇK peshat janë shprehur në për 100
- Në IHÇK peshat janë shprehur në për 1000

Kodi	Grupet	Peshat	
		IÇK	IHÇK
<b>Gjithsej</b>		<b>100,0</b>	<b>1.000,0</b>
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	40,0	380,2
02	Pije alkoolike dhe duhan	4,4	46,6
03	Veshje dhe këpucë	4,0	44,8
04	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,7	75,6
05	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje	6,5	69,5
06	Shëndeti	3,0	75,8
07	Transporti	6,2	71,9
08	Komunikimi	2,5	20,7
09	Argëtim dhe kulturë	2,6	20,8
10	Shërbimi arsimor	2,5	41,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	2,9	99,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4,7	53,3

# Shpjegime metodologjike

Nga muaji Janar 2017, INSTAT publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit i llogaritur në bazë të:

1. Rregullores së KE Nr 2494/95
2. Ligjit Nr.9180 dt.05.02.2004, për "Statistikat Zyrtare", i ndryshuar
3. Programit të Statistikave Zyrtare, 2017-2021.

Indeksi llogaritet dhe publikohet sipas strukturës së Klasifikimit Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore. ECOICOP është klasifikimi i shpenzimeve i përdorur nga EUROSTAT.

Periodha referuese e çmimeve është muaji Dhjetor 2016, ndërsa periodha referuese e indeksit është muaji Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015=100).

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit është llogaritur nga INSTAT edhe gjatë vitit 2016 duke patur si periodhë referuese indeksin e muajit Dhjetor 2015 (Dhjetor 2015 =100).

Peshat për IHÇK janë llogaritur në përputhje me Rregulloren e KE Nr.1114/2010 dhe Rregulloren e KE Nr. 1688/98. Peshat reflektojnë strukturën e Shpenzimeve Monetare të Konsumit Final të Familjeve shqiptare dhe jo shqiptare në territorin e Shqipërisë.

## - PËRKUFIZIME

**Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)** mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilido muaj

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.